

PHILIPS

HD9880

Manuali i përdorimit

Tabela e përmbajtjes

E rëndësishme	3
Fushat elektromagnetike (EMF)	5
Fikja automatike	5
Riciklimi	6
Garancia dhe mbështetja	6
Deklarata e konformitetit	6
Përditësimet e softuerit dhe firmuerit	6
Përputhshmëria e pajisjes	6
Rikthimi në parametrat e fabrikës	7
Hyrje	7
Shikim i përgjithshëm	7
Përshkrimi i funksioneve	8
Përpara përdorimit të parë	11
Përgatitjet para përdorimit të parë	11
Vendosja e rrjetës së heqshme fundore	11
Lidhja e Airfryer me programin NutriU	12
Përdorimi i Airfryer	14
Përdorimi i termometrit të ushqimit	18
Vendosja e termometrit të ushqimit	18
Matni trashësinë e ushqimit tuaj	20
Mënyrat e gatimit	21
Programet Auto-Cook	21
Skuqja e patateve të shtëpisë	22
Përgatitja e kosit të bërë në shtëpi	22
Gatim manual	22
Termometri i ushqimit	23
Mbajeni ngrohtë	24
My programs	25
Historiku i gatimit	25
Pastrimi	25
Tabela e pastrimit	26
Vendruajtja	26
Zgjidhja e problemeve	27

E rëndësishme

Lexojeni me kujdes këtë dokument informacioni të rëndësishëm përpara se ta vini në punë pajisjen dhe ruajeni për referencë në të ardhmen.

Rrezik

- Mos e vendosni pajisjen mbi apo pranë një stufe të nxehtë me gaz apo mbi të gjitha llojet e stufave elektrike dhe pianurave elektrike ose në një furrë të nxehtë.



- Mos e zhytni kurrë pajisjen në ujë dhe as mos e shpëlani në çezmë.
- Mos lejoni futjen e ujit ose të ndonjë lëngu tjetër brenda në pajisje, për të shmangur goditjen elektrike.
- Gjithmonë futini përbërësit për skuqje brenda koshit, për të parandaluar kontaktin e tyre me rezistencat e nxehtë.
- Mos i mbulonit vrimat e hyrjes dhe të daljes së ajrit ndërkohë që pajisja është duke punuar.
- Mos e mbushni tiganin me vaj pasi ky veprim mund të përbëjë rrezik për zjarr.
- Mos e përdorni pajisjen nëse spina, kordoni elektrik ose vetë pajisja është e dëmtuar.
- Mos e prekni kurrë pjesën e brendshme të pajisjes ndërkohë që është duke punuar.
- Mos futni kurrë sasi më të madhe ushqimi sesa niveli maksimal që tregohet te koshi.
- Gjithmonë sigurohuni që nxehtësi është i lirë dhe brenda tij nuk ka ngecur asnjë ushqim.

Paralajmërim

- Nëse kordoni elektrik është i dëmtuar, ai duhet ndërruar nga "Philips", agjenti i tij i servisit apo persona me kualifikim të ngjashëm, në mënyrë që të shmangen rreziqet.
- Pajisjen lidhni vetëm me priza të tokëzuara. Sigurohuni gjithnjë që spina të futet siç duhet në prizë.
- Kjo pajisje nuk është menduar të vihet në përdorim me anë të një kohëmatësi të jashtëm apo një sistemi të veçantë për komandimin nga distanca.
- Sipërfaqet e aksesueshme mund të nxehen gjatë përdorimit.



- Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijë të moshës 8 vjeç e lart dhe nga persona me aftësi të kufizuara fizike, ndijuese ose mendore, apo që kanë mungesë përvoja dhe njohurish vetëm nëse ata mbikëqyrin ose udhëzohen për përdorimin e sigurt të pajisjeve dhe nëse kuptojnë rreziqet e përfshira. Fëmijët nuk duhet të luajnë me pajisjen. Pastrimi dhe mirëmbajtja nga përdoruesi nuk duhen kryer nga fëmijët, përveç nëse janë më të mëdhenj se 8 vjeç dhe nën mbikëqyrje.
- Mbajeni pajisjen dhe kordonin larg vendeve ku mund të arrihet nga fëmijët e moshës nën 8 vjeç.
- Mos e mbështetni pajisjen në mur ose në pajisje të tjera. Lini të paktën 10 cm hapësirë të lirë në pjesën e pasme, në të dyja anë e pajisjet dhe sipër saj. Mos vendosni asgjë mbi pajisje.
- Gjatë skuqjes me ajër të nxehtë del avull i nxehtë nga vrimat e daljes së ajrit. Mbani duart dhe fytyrën në distancë të sigurt larg avullit dhe vrimave të daljes së ajrit. Gjithashtu tregohuni të kujdesshëm për avullin e nxehtë kur nxirrni tiganin nga pajisja.
- Mos përdorni kurrë përbërës me peshë të lehtë ose letër pjekjeje në pajisje.
- Sipërfaqet e aksesueshme mund të nxehen gjatë përdorimit.
- Ruajtja e patateve: Temperatura duhet të jetë e përshtatshme për varietetin e patates që ruhet dhe ajo duhet të jetë mbi 6°C për të minimizuar rrezikun e ekspozimit të akrilamidit në ushqimet e përgatitura.
- Mos hidhni kurrë vaj në tigan.
- Kjo pajisje është projektuar për t'u përdorur në temperaturë ambienti midis 5°C dhe 40°C.
- Përpara se ta vini në punë pajisjen kontrolloni nëse tensioni i treguar në pajisje përkon me tensionin e rrjetit elektrik lokal.
- Mbajeni kordonin elektrik larg sipërfaqeve të nxehta.
- Mos e vendosni pajisjen mbi apo pranë materialeve që marrin flakë, si për shembull mbulesë tavoline ose perde.
- Mos e përdorni pajisjen për asnjë qëllim tjetër përveç atij të përshkruar në këtë manual dhe përdorni vetëm aksesore origjinalë të Philips.
- Mos e lini pajisjen në punë pa mbikëqyrje.
- Tava, koshi dhe aksesoret nxehen gjatë dhe pas përdorimit të pajisjes, manovrojeni gjithmonë me kujdes.
- Përpara se ta përdorni pajisjen për herë të parë, pastrojini mirë pjesët që bien në kontakt me ushqimin. Referojuni udhëzimeve në manual.

Kujdes

- Kjo pajisje është parashikuar vetëm për përdorim të zakonshëm në shtëpi. Ajo nuk është menduar për përdorim në ambiente si kuzhinat profesionale apo dyqane, zyra, ferma ose ambiente të tjera pune. Ajo as nuk është menduar për përdorim nga klientët në hotele, motele, ambiente për fjetje dhe mëngjes dhe mjedise të tjera banimi.

- Shkëputeni gjithmonë pajisjen nga priza nëse e lini të pamonitoruar dhe përpara se ta montoni, çmontoni, ta vendosni në ruajtje ose përpara se ta pastroni.
- Vëreni pajisjen mbi një sipërfaqe horizontale, të drejtë dhe të qëndrueshme.
- Nëse pajisja përdoret në mënyrë të papërshtatshme apo për qëllime profesionale ose gjysmë-profesionale apo nuk përdoret sipas udhëzimeve në këtë manual përdorimi, garancia bëhet e pavlefshme dhe "Philips" refuzon çdo lloj përgjegjësie për dëmin e shkaktuar.
- Gjithmonë dërgojeni pajisjen në pikë servisi të autorizuar nga Philips për kontroll ose riparim. Mos tentoni ta riparoni vetë pajisjen, përndryshe garancia bëhet e pavlefshme.
- Hiqeni gjithnjë pajisjen nga priza pas përdorimit.
- Lëreni pajisjen të ftohet për rreth 30 minuta përpara se ta përdorni apo ta pastroni atë.
- Sigurohuni që përbërësit e përgatitur në këtë pajisje të dalin në ngjyrë të verdhtë të artë në vend të një ngjyre të verdhë të errët apo ngjyrë kafe. Largoni mbetjet e djegura. Mos skuqni patate të freskëta në temperaturë mbi 180°C (për të minimizuar krijimin e akrilamidit).
- Kini kujdes kur pastroni pjesën e sipërme të dhomës së gatimit: Mburoja e spërkatjes, rezistenca e nxehtë, skaji i pjesëve metalike.
- Sigurohuni gjithmonë që ushqimi në Airfryer është skuqur plotësisht.
- Sigurohuni gjithmonë që keni nën kontroll Airfryer, edhe kur përdorni funksionin e kontrollit nga largësia ose nisjen e vonuar.
- Kur gatuani ushqime me yndyrë, nga Airfryer mund të dalë tym. Tregoni kujdes të veçantë kur përdorni funksionin e kontrollit nga largësia ose nisjen e vonuar.
- Sigurohuni që funksioni i kontrollit nga largësia të përdoret vetëm nga një person në çdo rast.
- Bëni kujdes kur gatuani ushqime që prishen shpejt kur përdorni funksionin e nisjes së vonuar (mund të krijohen baktere).

Fushat elektromagnetike (EMF)

Kjo pajisje është në përputhje me standardet dhe rregulloret në fuqi për ekspozimin ndaj fushave elektromagnetike.

Fikja automatike

Airfryer është e pajisur me një funksion mbylljeje automatike. Kur pajisja ndizet por nuk është në modalitetin e gatimit ose të mbajtjes ngrohët, do të kalojë në modalitet pasiv pas 10 minutash mosveprimi nga përdoruesi. Për ta fikur manualisht pajisjen, shtypni gjatë butonin rrotullues.

Riciklimi

- Ky simbol do të thotë se produktet elektrike nuk duhet të hidhen me mbeturinat normale të shtëpisë. (Fig. 1)
- Ndiqni rregullat shtetërore për grumbullimin e veçuar të produkteve elektrike.



Garancia dhe mbështetja

Philips ofron një garanci 2-vjeçare në këtë produkt pas blerjes. Kjo garanci nuk vlen nëse defekti ndodh për shkak përdorimi të gabuar apo mosmirëmbajtjeje. Më shumë informacion ofrohet në internet. Vizitoni faqen tonë:

www.philips.com/support.

Deklarata e konformitetit

Nëpërmjet këtij dokumenti, DAP B.V. deklaron se Airfryer "HD9880" është në përputhje me Direktivën 2014/53/BE.

Teksti i plotë i deklaratës së konformitetit të BE-së gjendet në adresën e mëposhtme të internetit: **<https://www.philips.com>**.

Airfryer HD9880 është e pajisur me një modul Wi-Fi, 2,4 GHz 802.11 b/g/n me një fuqi maksimale dalëse prej 92,9 mW EIRP.

Përditësimet e softuerit dhe firmuerit

Përditësimi është thelbësor për të garantuar privatësinë tuaj dhe funksionimin e duhur të Airfryer dhe të programit.

Ju lutemi ta përditësoni gjithmonë programin në versionin më të fundit.

Airfryer po përditëson automatikisht firmuerin e pajisjes.

Shënim

- Për t'i mundësuar Airfryer të përditësohet në versionin më të fundit të firmuerit, sigurohuni që të jetë lidhur me Wi-Fi e shtëpisë.
- Përdorni gjithmonë programin dhe firmuerin më të fundit.
- Përditësimet ofrohen kur ka përmirësime të softuerit.
- Përditësimi i firmuerit nis automatikisht kur Airfryer është në modalitetin e pritjes. Ky përditësim zgjat disa minuta. Gjatë kësaj kohe Airfryer nuk mund të përdoret.

Përputhshmëria e pajisjes

Për informacion të detajuar në lidhje me përputhshmërinë e programit, shihni informacionin në App Store.

Rikthimi në parametrat e fabrikës

Për një rivendosje të Airfryer në vlerat e fabrikës, zgjidhni funksionin e rivendosjes së fabrikës në menyën Tools → Settings.


Pas kësaj, Airfryer nuk është më e lidhur me rrjetin Wi-Fi të shtëpisë suaj dhe nuk është më e çiftuar me pajisjen tuaj inteligjente.

Hyrje

Urime për blerjen dhe mirë se vini te Philips!

Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që ofron Philips, regjistroni produktin në faqen www.philips.com/welcome.

Shikim i përgjithshëm



1. Paneli i kontrollit
 - A. Treguesi Wi-Fi
 - B. Butoni i kthimit
 - C. Butoni rrotullues
 - D. Ekran
2. Foleja e termometrit të ushqimit
3. Sirtari
4. Rrjeta e heqshme fundore
5. Kosh me rrjetë të heqshme fundore
6. Tigani
7. Foleja e mbajtjes së kordonit
8. Vrimat e daljes së ajrit
9. Hyrja e ajrit
10. Treguesi i nivelit të mbushjes
11. Termometri i ushqimit
12. Mburoja e spërkatjes

Përshkrimi i funksioneve

Butoni rrotullues dhe mbrapa

Butoni rrotullues është komanda juaj qendrore. Mund ta rrotulloni dhe shtypni për të kaluar nëpër opsione të ndryshme të menysë dhe për të konfirmuar një veprim.

Shtypni shkurt butonin rrotullues: ndizni pajisjen.

Shtypni gjatë butonin rrotullues: fikni pajisjen.


Pasi pajisja të jetë ndezur:

Shtypni butonin rrotullues: konfirmoni një veprim.

Rrotulloni butonin rrotullues: kaloni nëpër opsione të ndryshme të menysë ose ndryshoni cilësimin e gatimit.

Shtypni shkurt butonin prapa: kthehuni te hapi i mëparshëm.

Shtypni gjatë butonin prapa: kthehuni te menyja kryesore.



Programet Auto-Cook


Programet Auto-Cook janë një nga veçoritë kryesore të Airfryer. Mund të zgjidhni nga një larmi artikujsh ushqimorë.

Vendosni nivelin e mbushjes së përbërësve tuaj ose tregoni Airfryer sa pjesë përbërësish (për shembull këmbë pule) keni futur në shportë, Airfryer do ta gatuajë automatikisht ushqimin.

Nëse nevojitet ndërveprim gjatë gatimit (p.sh. tundja e patateve), Airfryer do t'ju njoftojë.

Termometri i ushqimit

Airfryer vjen me një termometër ushqimi, i cili mund të përdoret për të gatuar ushqimin në nivelin e dëshiruar. Vendosni njërin skaj të termometrit të ushqimit te ushqimi dhe skajin tjetër në folenë e termometrit të ushqimit (shih kapitullin “Termometri i ushqimit”). Mund ta përdorni termometrin e ushqimit në modalitetet e gatimit “**Food thermometer**” dhe “**Auto-Cook programs**”.



Koha e gatimit

Në modalitetin e gatimit “**Manual cooking**”, mund të caktoni kohën e gatimit nga 1 minutë në 180 minuta.

Në modalitetin e gatimit “**Auto-Cook programs**”, nuk keni nevojë të vendosni një kohë gatimi pasi programi i gatimit automatik gatuan ushqimin sipas madhësisë së porcionit ose nivelin e dëshiruar.

Në modalitetin e gatimit “**Food thermometer**”, nuk keni nevojë të vendosni kohë gatimi pasi gatimi përfundon automatikisht sapo të arrihet temperatura e caktuar e termometrit të ushqimit.

Temperatura e gatimit

Në modalitetet e gatimit “**Manual cooking**” dhe “**Food thermometer**” mund të vendosni temperaturën e gatimit nga 40°C në 200°C.

Në modalitetin e gatimit “**Auto-Cook programs**”, nuk keni nevojë të vendosni temperaturën e gatimit sepse temperatura e gatimit vendoset automatikisht.

Temperatura bazë

Në modalitetin e gatimit “**Food thermometer**”, mund të vendosni temperaturën bazë të ushqimit. Temperatura në qendër të ushqimit do të arrijë temperaturën e vendosur bazë në fund të procesit të gatimit.

Shënim

- Temperatura bazë nuk është e barabartë me temperaturën e gatimit.

Shpejtësitë e larta dhe të ulëta të ajrit

Airfryer vjen me dy cilësime të ndryshme të shpejtësisë së ajrit, një Air Speed të ulët (Ⓐ) dhe Air Speed të lartë (ⒸⒶ).

Në modalitetin e gatimit "**Auto-Cook programs**", shpejtësia e ajrit vendoset automatikisht.

Në modalitetet e gatimit "**Manual cooking**" ose "**Food Thermometer**", duhet të vendosni manualisht shpejtësinë e ajrit.

Për gatimet tipike të furrës, si lazanja, rosto, ëmbëlsira etj. dhe për një kohë të gjatë gatimi, përdorni shpejtësinë e ulët të ajrit. Për raste tipike përdorimi të Airfryer, si p.sh. patate të skuqura, kofshë pule, fileta peshku etj. dhe për kohë më të shkurtër gatimi, përdorni shpejtësinë e lartë të ajrit.

Funksioni i mbajtjes ngrohtë

Airfryer vjen me një modalitet mbajtjeje ngrohtë. Mund të aktivizoni mbajtjen ngrohtë direkt pas gatimit ose mund të kaloni te mbajtja ngrohtë nga menya kryesore.

My programs

Mund t'i ruani programet e preferuara të gatimit automatik, cilësimet e recetave ose cilësimet manuale të gatimit te "**My programs**". Lista juaj mund të ruajë deri në 20 zëra. Zgjidhni një artikull dhe filloni gatimin menjëherë.

Historiku i gatimit

Artikujt e gatuar së fundi mund t'i gjeni te "**Cooking history**". Mund të shihni 20 zërat më të fundit të historikut të gatimit. Zgjidhni një artikull dhe filloni gatimin menjëherë.

Funksioni i vlerësimit

Mund t'i vlerësoni programet Auto-Cook dhe të gjitha recetat e NutriU pas gatimit. Vlerësimi ruhet automatikisht dhe mund ta gjeni te "**My Programs**" dhe te "**Cooking history**". Vlerësimi do të ndihmojë në përmirësimin e programeve dhe të recetave të gatimit automatik.

Kujtuesi i pastrimit

Herë pas here do të merrni një rikujtesë për të pastruar pjesën e brendshme të Airfryer. Te "**Settings**" mund të çaktivizoni rikujtesën e pastrimit.

Rikujtesa e tundjes

Kur gatواني me një cilësim manual, pas gjysmës së kohës së caktuar të gatimit do të merrni një rikujtesë tundjeje. Te "**Settings**" mund ta çaktivizoni rikujtesën e tundjes.

Njoftimet zanore

Ndonjëherë mund të dëgjoni një tingull, për shembull kur pajisja ka përfunduar gatimin, ose kur kërkohet një veprim gjatë gatimit, p.sh., tundja ose rrotullimi i ushqimit.

Asistenti i tekstit

Të gjitha ekranet e menysë vijnë me një asistent teksti, i cili ju ndihmon të lëvizni nëpër meny.


Përpara përdorimit të parë

1. Hiqni të gjithë materialin e paketimit.
2. Hiqni çdo ngjitëse ose etiketë (nëse ka) nga pajisja.
3. Hiqni shtresën mbrojtëse nga ekran.
4. Pastrojeni plotësisht pajisjen përpara përdorimit të parë (shih kapitullin "Pastrimi").


Përgatitjet para përdorimit të parë

Vendosja e rrjetës së heqshme fundore


1. Hapni sirtarin duke tërhequr dorezën.




2. Hiqni koshin duke ngritur dorezën.




3. Futni rrjetën e heqshme fundore në folenë në anën djathtë poshtë të koshit. Shtyjeni rrjetën fundore për poshtë derisa të puthitet në vend ("klik" në të dy anët).



4. Vendoseni koshin në tigan.



5. Tërhiqeni sirtarin mbrapsht në Airfryer nga doreza.



Shënim


- Asnjëherë mos e përdorni tiganin pa kosh.

Lidhja e Airfryer me programin NutriU

E rëndësishme

- Sigurohuni që pajisja juaj inteligjente të jetë e lidhur me rrjetin WiFi në shtëpi përpara se të filloni procesin e konfigurimit të WiFi.


1. Futeni pajisjen në prizë



2. Shtypni butonin rrotullues për të ndezur pajisjen.

Shënim

- Kur e ndizni pajisjen për herë të parë, do t'ju kërkohet të zgjidhni gjuhën.
- Mund ta ndryshoni gjuhën në çdo kohë në menynë **"Settings"**.



3. Lëvizni nëpër listë derisa gjuha që preferoni të theksohet.
4. Shtypni butonin rrotullues për të konfirmuar dhe për të vazhduar.
5. Zgjidhni njësinë e peshës dhe të temperaturës nga lista.

Shënim

- Në ekranin tjetër mund të vendosni nëse ta lidhni pajisjen me pajisjen inteligjente menjëherë ose ta bëni më vonë.
6. Nëse vendosni ta lidhni pajisjen menjëherë me pajisjen inteligjente, kaloni tek opsioni **"Yes, please"**.

Shënim

- Ju rekomandojmë të shkarkoni programin NutriU dhe të shtoni Airfryer në program sapo ta konfiguroni pajisjen për herë të parë. Kjo ju mundëson ta përdorni Airfryer më së miri, për shembull, për gatime në distancë (i nisni recetat ose programet e gatimit automatik nga programi, merrni njoftime kur ushqimi është gati etj.) dhe për të marrë përditësimet më të fundit të firmuerit.

7. Shfaqet një kod QR. Skanojeni për të shkarkuar programin NutriU.



Këshillë

- Programin NutriU mund ta shkarkoni dhe nga App Store ose nga faqja e internetit **www.philips.com/NutriU**.

8. Hapni programin NutriU dhe ndiqni procesin e regjistrimit.
9. Ndiqni hapat në program për ta lidhur Airfryer me Wi-Fi dhe për të çiftuar Airfryer me pajisjen inteligjente.

E rëndësishme

- **Telekomanda:** mund ta kontrolloni Airfryer nga distanca nëpërmjet programit (p.sh. të dërgoni një recetë, të ndaloni gatimin etj.) vetëm nëse keni piketuar “remote consent” në programin NutriU, që gjendet në profilin tuaj të NutriU.
- Sigurohuni që ta lidhni Airfryer me një rrjet Wi-Fi shtëpie 2,4 GHz 802.11 b/g/n.
- Çiftimi me një përdorues: Airfryer mund të komandohet në distancë nga vetëm një përdorues gjatë një kohe të caktuar. Nëse një përdorues i dytë dëshiron ta komandojë Airfryer dhe të përdorë programin NutriU, duhet të ndjekë procesin e çiftimit. Pasi të çiftohet, përdoruesi i parë do të çiftohet automatikisht.
- Procesi i konfigurimit të Wi-Fi mund të anulohet nëpërmjet programit ose duke e hequr Airfryer nga priza.

Treguesi Wi-Fi

Treguesi WiFi është i fikur.	Wi-Fi është joaktive.
Treguesi WiFi është i ndezur.	WiFi është aktiv dhe i lidhur me ruterin.
Treguesi Wi-Fi vezullon ngadalë.	Lidhja Wi-Fi është në proces.
Treguesi Wi-Fi vezullon shpejt.	Gabim i lidhjes Wi-Fi.

Shënim

- Mund ta aktivizoni ose çaktivizoni Wi-Fi te Settings – Wi-Fi settings – Turn OFF / ON Wi-Fi.
- Mund ta nisni konfigurimin e Wi-Fi te Settings – Wi-Fi settings – Wi-Fi Setup mode.

Përdorimi i Airfryer

Kujdes


- Kjo është një Airfryer që punon me ajër të nxehtë. Mos e mbushni tiganin me vaj, yndyrë skuqjeje apo ndonjë lëng tjetër.
- Mos i prekni sipërfaqet e nxehta. Përdorni dorezat ose rrotullat. Kapeni tiganin e nxehtë me doreza të sigurta për furrë.
- Kjo pajisje është vetëm për përdorim shtëpiak.
- Kjo pajisje mund të lëshojë njëfarë tymi kur e përdorni për herë të parë. Kjo është normale.
- Nuk është e nevojshme që pajisja të ngrohet paraprakisht.

1. Vëreni pajisjen mbi një sipërfaqe të qëndrueshme, horizontale, të rrafshët dhe rezistente ndaj nxehtësisë. Sigurohuni që sirtari të mund të hapet tërësisht.


Shënim

- Mos vendosni asgjë sipër ose në anët e pajisjes. Kjo mund të ndërpresë rrjedhën e ajrit dhe të ndikojë në rezultatin e skuqjes.


2. Tërhiqni kordonin elektrik nga foleja e mbajtjes së kordonit mbrapa pajisjes.



3. Futeni spinën në prizë.




4. Hapni sirtarin duke tërhequr dorezën.




5. Vëriini përbërësit në kosh.

Shënim


- Mos e mbushni shportën përtej treguesit "MAX", pasi mund të ndikojë në rezultatin përfundimtar.



6. Rrëshqiteni sirtarin përsëri në Airfryer.



7. Shtypni butonin rrotullues për të ndezur pajisjen.



8. Zgjidhni mënyrën e gatimit që dëshironi të përdorni (shih kapitullin "Mënyrat e gatimit").

9. Ndiqni hapat në ekran. Hapat ndryshojnë në varësi të mënyrës së zgjedhur të gatimit.

Kujdes


- Mos e përdorni tiganin pa koshin brenda. Nëse e ngrohni pajisjen pa koshin, përdorni dorezat e furrës për të hapur sirtarin. Skajet dhe brendësia e sirtarit bëhen shumë të nxehta.
- Mos i prekni tiganin dhe shportën gjatë përdorimit dhe për ca kohë pas përdorimit, pasi nxehen shumë.

10. Shtypni butonin rrotullues për të filluar gatimin ose rrotullojeni nëse dëshironi të ndryshoni një cilësim gatimi. Cilësimi që mund të ndryshohet ndizet në ekran. Shtypni butonin rrotullues dhe kthejeni për të ndryshuar cilësimin.


11. Kur dëgjoni zilen e kohëmatësit, është koha për të tundur ushqimin ose koha e gatimit ka kaluar.

Shënim

- Gjithmonë sigurohuni që ushqimi juaj të jetë gatuar plotësisht përpara se ta shërbeni.
- Disa programe të gatimit automatik ju njoftojnë kur kërkohet tundja ose rrotullimi i ushqimit. Airfryer do të dërgojë një sinjal zanor kur është koha për ta tundur ose kthyer.
- Mënyra më e mirë për ta tundur është të hapni sirtarin dhe ta hiqni koshin nga tigani dhe ta tundni. Më pas rrëshqitni tiganin me shportën përsëri në pajisje. Pajisja do të rifillojë automatikisht gatimin.
- Për të anuluar çdo proces në ekzekutim, kthehuni te menyja kryesore duke shtypur butonin e kthimit (↩).




- 12.** Hapni sirtarin duke tërhequr nga doreza dhe kontrolloni nëse përbërësit janë gati.



Shënim

- Nëse përbërësit nuk janë ende gati, thjesht rrëshqitni sirtarin përsëri në Airfryer nga doreza dhe shtoni disa minuta të mëtejshme duke përdorur opsionin **"Add more time"**.


- 13.** Për të hequr përbërësit e vegjël (p.sh. patatet e skuqura), nxirreni koshin nga tigani me anë të dorezës.



Kujdes

- Pasi të ketë mbaruar procesi i gatimit, tigani, koshi, kutia e brendshme dhe përbërësit janë të nxehtë. Në varësi të llojit të përbërësve në Airfryer, mund të dalë avull nga tigani.

- 14.** Zbrazeni përmbajtjen e koshit në tas ose në një pjatë. Hiqeni gjithnjë koshin nga tigani për të zbrazur përmbajtjen, pasi mund të ketë vaj të nxehtë në fund të tiganit.



Shënim

- Për të hequr përbërës të mëdhenj ose të brishtë, përdorni një palë kapëse për ngritjen e përbërësve.
- Vaji i tepërt ose yndyra e përdorur nga përbërësit mbledhen në fund të tiganit.
- Në varësi të llojit të përbërësve në gatim, mund të dëshironi ta derdhni me kujdes vajin ose yndyrën e përdorur jashtë tiganit pas çdo grupi ose përpara tundjes a rifutjes së koshit në tigan. Vendoseni koshin në një sipërfaqe rezistente ndaj nxehtësisë. Duke mbajtur doreza të sigurta për furrë, nxirreni tiganin nga kanalet e veta dhe vendoseni në një sipërfaqe nxehtësiduruese. Derdheni vajin e tepërt ose yndyrën e përdorur. Kthejeni tiganin në sirtar dhe shportën në tigan.
- Kur një grup përbërësish janë gati, Airfryer është në çast gati për të bërë grupin e radhës.


Përdorimi i termometrit të ushqimit

Vendosja e termometrit të ushqimit

Termometri i ushqimit mund të përdoret për biftek, bërçolla, gjoks pule, fileta peshku etj.


Pastrojeni termometrin e ushqimit para dhe pas përdorimit - përdorni ujë të ngrohtë dhe me sapun.

1. Futeni termometrin në qendër të pjesës më të trashë të ushqimit.



Shënim


- Sigurohuni që maja e termometrit të jetë futur drejt në qendër të pjesës më të trashë të ushqimit, jo me kënd nga fundi ose sipër tij.



- Sigurohuni që termometri të jetë afër, por jo duke prekur kockën dhe larg çdo yndyre apo kërci.
- Pjesa më e trashë e filetës mund të mos jetë qendra. Është e rëndësishme që fundi i termometrit të kapë pjesën më të trashë në mënyrë që të arrihen rezultatet e dëshiruara.
- Kur skuqni një pulë të tërë në ajër, sigurohuni që termometri të mos shkojë deri në gjoks nga zgavra.
- Mos e përdorni termometrin e ushqimit nëse ushqimi është më pak se 2 cm i trashë.

Këshillë

- Ndiqni hapat e mëposhtëm për ta drejtuar termometrin në qendër të ushqimit.
 1. Kopeni kërcellin metalik të termometrit dhe vendoseni majën në qendër të ushqimit.
 2. Mbani gishtat në të njëjtin pozicion kapjeje dhe futeni termometrin në qendër të pjesës më të trashë të ushqimit.







Shënim

- Në varësi të artikullit ushqimor, nuk është gjithmonë e nevojshme ta fusni plotësisht kërcellin metalik të termometrit të ushqimit.

Kujdes


- Maja e termometrit të ushqimit është e theksuar.

Çfarë duhet bërë	Çfarë s'duhet bërë
	
	
	


Matni trashësinë e ushqimit tuaj

Mund ta përdorni termometrin e ushqimit për të matur trashësinë e ushqimit.

1. Vendoseni termometrin e ushqimit pranë ushqimit dhe kontrolloni se cila shenjë arrin në majë të ushqimit.



2. Vendosni vlerën nga 1 në 6 në Airfryer kur pyeteni për trashësinë nëse gatueri me një program Auto-Cook.



Mënyrat e gatimit

Mode (Modaliteti)		Mënyrat
Programet Auto-Cook		Zgjidhni programin Auto-Cook nga lista. Ndiqni hapat në pajisje. Programet Auto-Cook llogaritin automatikisht të gjitha parametrat e gatimit bazuar në të dhënat tuaja, si p.sh. niveli i mbushjes ose numri i copave etj. Më pas filloni gatimin.
Gatim manual		Vendosni manualisht kohën e gatimit, temperaturën dhe shpejtësinë e ajrit dhe filloni gatimin.
Termometri i ushqimit		Vendosni manualisht temperaturën bazë, temperaturën e gatimit dhe shpejtësinë e ajrit dhe filloni gatimin.

Programet Auto-Cook

1. Rrotulloni butonin rrotullues derisa të zgjidhet "Auto-Cook Programs". Shtypni butonin rrotullues për të hyrë në këtë modalitet.
2. Shtypni butonin rrotullues për të konfirmuar.
3. Rrotulloni butonin rrotullues për të zgjedhur programin Auto-Cook që ju nevojitet. Shtypni butonin rrotullues për të konfirmuar.
4. Zgjidhni sasinë e ushqimit që keni futur në shportë.

Shënim

- Në varësi të ushqimit, mund t'ju kërkohet të vendosni nivelin e mbushjes, copat, peshën, trashësinë dhe/ose nivelin e gatishmërisë.
- Përdorni shenjat e treguara në shportë si referencë për të vendosur nivelin e duhur të mbushjes.
- Përpara se të zgjidhni nivelin e mbushjes, sigurohuni që gjithmonë ta shpërndani ushqimin në mënyrë të barabartë në shportë.
- Kthejeni/shkundni ushqimin nëse tregohet nga pajisja. Mbajeni sirtarin të hapur sa më shkurt që të jetë e mundur.
- Kur zgjidhni një nivel gatishmërie të një programi Auto-Cook, duhet të përdorni termometrin e ushqimit.
- Për disa programe të gatimit automatik, duhet të futni peshën e ushqimit. Përdorni një peshore për të përcaktuar peshën ose mund të gjeni peshën edhe në paketimin e ushqimit tuaj.

Skuqja e patateve të shtëpisë

Për patate fantastike shtëpie në Airfryer:

- Zgjidhni një variete patatesh të përshtatshme për skuqje, p.sh. patate të freskëta, (pak) miellëse.
 - Është mirë që të skuqni patate të skuqura në pjesë deri në nivelin e mbushjes 4 për një rezultat të barabartë.
1. Qëroni patatat dhe pritini në shkopinj. Patatat e mëdha priren të jenë më pak krokante se të voglat.
 2. Njomini patatat e prera në një tas me ujë për të paktën 30 minuta.
 3. Zbrazeni tasin dhe thajini patatat e prera me një pecetë enësh ose letre.
 4. Hidhni një lugë gjelle vaj gatimi në tas, vendosini patatat në tas dhe trazojini derisa patatat të vishen me vaj.
 5. Hiqini patatat nga tasi me gishta ose një kapëse kulluese që vaji të mbetet në tas.

Shënim

- Mos e anoni tasin për t'i hedhur të gjitha patatat e prera njëherësh në kosh, që të evitoni derdhjen e vajt të tepërt në tigan.
6. Hidhni patatat e prera në kosh.
 7. Nisni programin Auto-Cook të patate të skuqura shtëpiake dhe tundeni kur të njoftoheni.

Përgatitja e kosit të bërë në shtëpi

1. Përzieni në një tas 1 3/4 litër qumësht dhe 3 lugë kos. Sigurohuni që përmbajtja e yndyrës në qumësht dhe në kos të jetë e njëjtë.
2. Hidhni 150-200ml në çdo gotë të vogël dhe mbylleni me kapak.
3. Vendosini gotat në koshin e Airfryer dhe mbyllni sirtarin.
4. Nisni "Auto-Cook Program" - "Yogurt" (The unexpected->Dairy->Yogurt).
5. Fermentimi do të zgjasë afërsisht 8 orë. Mos e hapni Airfryer sakaq.
6. Vendosini gotat në frigorifer dhe shijoni kosin e bërë në shtëpi kur të ftohet.

Gatim manual

1. Rrotulloni butonin rrotullues derisa të zgjidhet "Manual cooking". Shtypni butonin rrotullues për të hyrë në këtë modalitet.
2. Rregulloni kohën duke rrotulluar butonin rrotullues. Mund të zgjidhni një kohë nga 1 deri në 180 minuta. Konfirmoni duke shtypur butonin rrotullues.

3. Rregulloni temperaturën duke rrotulluar butonin rrotullues. Mund të zgjidhni një temperaturë nga 40°C deri në 200°C. Konfirmoni duke shtypur butonin rrotullues.
4. Rregulloni shpejtësinë e ajrit duke rrotulluar butonin rrotullues. Mund të zgjidhni midis shpejtësisë së lartë të ajrit dhe shpejtësisë së ulët të ajrit. Konfirmoni duke shtypur butonin rrotullues.
 - Më pas shihni një përmbledhje të parametrave të zgjedhur të gatimit. Nëse dëshironi të ndryshoni një cilësim gatimi, kthejeni butonin rrotullues në parametrin që dëshironi të ndryshoni. Shtypni dhe rrotullojeni për të ndryshuar parametrin. Pasi të konfirmohen të gjithë parametrat e gatimit, shtypni butonin rrotullues për të filluar gatimin. Do të shihni kohëmatësin duke numëruar mbrapsht.

Shënim

- Nëse dëshironi të merrni një rikujtesë për tundje pas gjysmës së kohës së gatimit, sigurohuni që të jetë aktivizuar rikujtesa e tundjes.
- Mund ta ndaloni Airfryer duke shtypur butonin rrotullues gjatë gatimit. Për të rregulluar parametrat, ndiqni hapat e mësipërm. Për të vazhduar gatimin, shtypni sërish butonin rrotullues.

Termometri i ushqimit

1. Rrotulloni butonin rrotullues derisa të zgjidhet "Food thermometer". Shtypni butonin rrotullues për të hyrë në këtë modalitet.
2. Rregulloni temperaturën e dëshiruar bazë (matur në majën e termometrit të ushqimit) duke rrotulluar butonin rrotullues. Mund të zgjidhni një temperaturë nga 30 në 99°C. Konfirmoni duke shtypur butonin rrotullues.
 - Do të shihni animacione se ku të vendosni më mirë majën e termometrit në ushqim dhe se si kabloja do të drejtohet nga dhoma e gatimit në pjesën e jashtme, në mënyrë që sirtari të mbyllet.
3. Fusni kabllon në folenë e termometrit të ushqimit.

Shënim

- Konfirmoni anashkalimin e animacioneve duke shtypur butonin rrotullues.
4. Rrotulloni butonin rrotullues për të rregulluar temperaturën e gatimit. Mund të zgjidhni një temperaturë nga 40°C deri në 200°C. Konfirmoni duke shtypur butonin rrotullues.
 5. Rregulloni shpejtësinë e ajrit duke rrotulluar butonin rrotullues. Mund të zgjidhni midis shpejtësisë së lartë të ajrit (🌀) dhe shpejtësisë së ulët të ajrit (🌀). Konfirmoni duke shtypur butonin rrotullues.
 6. Më pas shihni një përmbledhje të parametrave të zgjedhur të gatimit. Nëse dëshironi të ndryshoni një cilësim gatimi, kthejeni butonin rrotullues në parametrin që dëshironi të ndryshoni. Shtypni dhe rrotullojeni për të ndryshuar parametrin. Shtypni butonin rrotullues për të filluar gatimin.

Shënim

- Do të shihni temperaturën aktuale bazë të ushqimit dhe temperaturën e synuar pranë njëra-tjetrës duke alternuar me kohëmatësin që numëron në rritje.

Tabela e mëposhtme ju jep një udhëzim se cila temperaturë të brendshme duhet vendosur.

Artikull ushqimor	Niveli i gatishmërisë	Temperatura bazë
Shpendë në përgjithësi	U krye	80-85°C
Gjoks shpendësh	Të lëngshme	70-74°C
Mish lope, viç, qengj, mish dreri	Pjekur pak	45-50°C
	Mesatar	55-60°C
	Pjekur mirë	65-70°C
Mish derri në përgjithësi	U krye	70-73°C
Ijë derri	Mesatar	58-63°C
Peshk	E tejdukshme	50-55°C
	U krye	60-65°C
Patate e plotë	U krye	92-95°C
Bukë	U krye	90-95°C

Shënim

- Temperatura e sugjeruar bazë nuk përkon doemos me temperaturën e brendshme minimale të sigurt të ushqimit.
- Temperatura e brendshme e ushqimit të gatuar do të vazhdojë të rritet disa gradë pasi të jetë nxjerrë ushqimi nga pajisja.

Mbajeni ngrohtë

1. Rrotulloni butonin rrotullues derisa të zgjidhet "Keep warm". Shtypni butonin rrotullues për të hyrë në këtë modalitet.

Shënim

- Për të ndryshuar kohën e mbajtjes së ngrohtë, rrotulloni butonin rrotullues. Shtypni dhe më pas rrotulloni butonin rrotullues për të rregulluar kohën e mbajtjes së ngrohtë. Mund të caktoni kohën e mbajtjes së ngrohtë nga 1 deri në 30 minuta. Shtypni butonin rrotullues për të konfirmuar vendosjen e kohës së mbajtjes ngrohtë.

2. Shtypni butonin rrotullues për të filluar mbajtjen ngrohtë.

Shënim

- Mund të ndaloni për të mbajtur ngrohtë duke shtypur butonin rrotullues.

My programs

1. Rrotulloni butonin rrotullues derisa të zgjidhet "My programs". Shtypni butonin rrotullues për të hyrë në këtë modalitet.
2. Kthejeni butonin rrotullues në programin e dëshiruar. Nëse qëndroni në një program, shfaqen parametrat e gatimit.
3. Shtypni butonin rrotullues për të hyrë në programin e zgjedhur. Shtypni përsëri butonin rrotullues për të filluar gatimin.
 - Kthejeni dhe shtypni butonin rrotullues ose për të hequr programin ose për ta riemërtuar.

Historiku i gatimit

1. Rrotulloni butonin rrotullues derisa të zgjidhet "Cooking history". Shtypni butonin rrotullues për të hyrë në këtë modalitet.
2. Kthejeni butonin rrotullues në artikullin e dëshiruar. Nëse qëndroni në një artikull, shfaqen parametrat e gatimit.
3. Shtypni butonin rrotullues për të hyrë në artikullin e zgjedhur. Shtypni përsëri butonin rrotullues për të filluar gatimin.
 - Kthejeni dhe shtypni butonin rrotullues, shtojeni te "My programs".

Pastrimi

Paralajmërim

- Lëreni shportën, tiganin dhe pjesën e brendshme të pajisjes të ftohet plotësisht përpara se të filloni pastrimin.
- Tava dhe koshi i pajisjes kanë një shtresë që nuk ngjit. Mos përdorni enë kuzhine metalike ose materiale gërryese pastrimi, pasi mund të dëmtoni veshjen jongjitëse.

Këshillë




- Hiqni tiganin dhe shportën që Airfryer të ftohet më shpejt.
1. Hidheni yndyrën ose vajin e përdorur nga fundi i tiganit.
 2. Pastroni tiganin, shportën në një makinë enëlarëse. Gjithashtu mund t'i pastroni me ujë të nxehtë, solucion për larjen e enëve dhe një sfungjer jogërryes (shihni "Tabelën e pastrimit").

Këshillë

- Nëse mbetjet e ushqimit ngecin në tigan ose shportë, mund t'i zhytni në ujë të nxehtë dhe në lëng për larjen e enëve për 10-15 minuta. Njomja i liron mbetjet ushqimore dhe lehtëson heqjen e tyre. Sigurohuni që të përdorni një lëng larës që mund të shpërbëjë vajin dhe yndyrën. Nëse ka njolla yndyre në tigan ose në kosh dhe nuk keni pasur mundësi t'i hiqni me ujë të nxehtë dhe detergjent enësh, përdorni sgrasator.
- Nëse është e nevojshme, mbetjet e yndyrës që janë ngjitur në mburojën e spërkatjes, mund të hiqen me një sfungjer ose furçë.

3. Fshijeni pjesën e jashtme të pajisjes me një leckë të njomë. Sigurohuni që të mos mbetet lagështi mbi panelin e kontrollit. Thani panelin e kontrollit me një leckë pasi ta keni pastruar.
4. Pastroni mburojën e spërkatjes me një sfungjer ose një furçë pastrimi për të hequr çdo mbetje yndyre.
5. Pastrojeni brendësinë e pajisjes me ujë të nxehtë dhe sfungjer jogërryes.

Tabela e pastrimit

			
	✓	✓	✗
	✓	✓	✗
	✓	✓	✗
	✓	✗	✓

Vendruajtja

1. Hiqeni pajisjen nga priza dhe lëreni të ftohet.
2. Sigurohuni që të gjitha pjesët të jenë të pastra dhe të thata përpara se t'i ruani.
3. Futeni kordonin në folenë e ruajtjes së kordonit.

Shënim

- Mbajeni gjithmonë Airfryer horizontalisht kur e transportoni. Sigurohuni gjithashtu që ta mbani sirtarin në pjesën e parme të pajisjes pasi mund të rrëshqasë jashtë pajisjes nëse anohet gabimisht për poshtë. Kjo mund të sjellë dëmtimin e sirtarit.
- Sigurohuni gjithnjë që pjesët e heqshme të Airfryer, p.sh. rrjeta e heqshme fundore etj., të fiksohen përpara se ta transportoni dhe/ose magazinoni.

Zgjidhja e problemeve

Ky kapitull përmbledh problemet më të shpeshta që mund të hasni me pajisjen. Nëse nuk mundeni ta zgjidhni problemin me informacionin e mëposhtëm, vizitoni **www.philips.com/support** për një listë të pyetjeve më të shpeshta ose kontaktoni me qendrën e shërbimit të klientit për shtetin tuaj.

Problemi	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
Pjesa e jashtme e pajisjes nxehet gjatë përdorimit.	Nxehtësia brenda rrezaton në muret e jashtme.	Kjo është normale. Të gjitha dorezat dhe pullat që duhet të prekni gjatë përdorimit qëndrojnë mjaftueshëm të ftohta për t'i prekur.
		Tigani, koshi dhe brendësia e pajisjes mund të nxehen gjithnjë kur pajisja ndizet për t'u siguruar që ushqimi të gatuhet siç duhet. Këto pjesë janë gjithmonë shumë të nxehta për t'u prekur.
		Nëse e lini pajisjen të ndezur për një kohë më të gjatë, disa zona nxehen shumë për t'u prekur. Këto zona janë shënuar në pajisje me ikonën e mëposhtme:  Për sa kohë që jeni të vetëdijshëm për zonat e nxehta dhe shmangni prekjen e tyre, pajisja është plotësisht e sigurt për t'u përdorur.

Problemi	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
Patatet e skuqura të shtëpisë nuk dalin ashtu siç i prisja.	Nuk keni përdorur llojin e duhur të patateve.	Për rezultate optimale, përdorni patate të freskëta miellëse. Nëse ju duhet t'i ruani patatet për më vonë, mos i mbani në ambient të ftohtë, si p.sh. frigoriferi. Zgjidhni patate paketimi i të cilave pohon se janë të përshtatshme për skuqje.
	Sasia e përbërësve në kosh është shumë e madhe.	Mos e tejmbushni shportën.
	Përbërës të llojeve të caktuara mund të jetë nevoja të tunden deri në gjysmën e kohës së gatimit.	Sa më e mbushur të jetë shporta aq më shpesh rekomandohet të tundet.
Airfryer nuk ndizet.	Pajisja nuk është në prizë.	Kontrolloni nëse spina është futur siç duhet në prizën e murit.
	Disa pajisje janë të lidhura në një prizë.	Airfryer ka fuqi të lartë. Provoni një prizë tjetër dhe kontrolloni siguresat.
Dalloj disa zona të rrjepura brenda Airfryer sime.	Disa njolla të vogla mund të shfaqen brenda tiganit të Airfryer për shkak të prekjes ose gërvishtjes së rastësishme të veshjes (p.sh. gjatë pastrimit me mjete të forta pastrimi dhe/ose gjatë futjes së koshit).	Mund ta parandaloni dëmtimin duke e ulur me kujdes koshin në tigan. Nëse e futni koshin me kënd, ana e tij mund të përpiqet kundër mureve të tiganit duke shkaktuar ciflosjen e veshjes. Nëse ndodh diçka e tillë, vini re se kjo nuk është e rrezikshme pasi të gjitha materialet e përdorura janë të sigurta për përdorim ushqimor.
Del tym i bardhë nga pajisja.	Po gatueri përbërës të yndyrshëm.	Derdheni me kujdes tepicën e vajit ose të yndyrës nga tigani dhe vazhdoni me gatimin.

Problemi	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
	Tigani përmban ende mbetje të yndyrshme nga përdorimi i mëparshëm.	Tymi i bardhë shkaktohet nga mbetjet e yndyrshme që ngrohin tiganin. Pastrojeni gjithnjë me kujdes tiganin dhe koshin pas çdo përdorimi.
	Buka ose kuvertura nuk ngjitet mirë me ushqimin.	Thërrime të vogla buke mund të shkaktojnë tym të bardhë. Shtypeni mirë mbulimin me bukë ose kuverturën me ushqimin për t'u siguruar që të ngjisin.
	Marinadat, lëngjet e ndryshme ose të mishit spërkaten në yndyrën e përdorur.	Takojeni ushqimin derisa të thahet përpara se ta vendosni në kosh.
Llamba e Wi-Fi në Airfryer time nuk ndizet më.	Airfryer nuk është më e lidhur me Wi-Fi të shtëpisë. Keni ndryshuar rrjetin Wi-Fi të shtëpisë.	Filloni procesin e konfigurimit të Wi-Fi dhe ndiqni udhëzimet në program.
Programi tregon se procesi i çiftimit nuk është i suksesshëm.	Një përdorues tjetër e ka çiftuar Airfryer me një pajisje tjetër inteligjente dhe është duke gatuar.	Prisni derisa përdoruesi tjetër të ketë përfunduar procesin aktual të gatimit dhe riçiftojeni pajisjen inteligjente me Airfryer.

